

RREGULLORE NR. 1999/21

UNMIK/RREG/1999/21

15 nëntor 1999

PËR LICENCIMIN, MBIKËQYRJEN DHE RREGULLIMIN E BANKAVE

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë të datës 25 korrik 1999,

Me qëllim të vendosjes së rregullave për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave në Kosovë (BPK),

Shpall sa vijon:

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

FUSHA E VEPRIMIT

– Kjo rregullore zbatohet për institucionet bankare dhe financiare, aksionerët e tyre, administratorët, punonjësit, agjentët dhe filialet.

Neni 2

PËRKUFIZIMET

– Termat e mëposhtëm, kudo që përdoren në këtë rregullore, kanë këto kuptime:

“administrator” nënkupton çdo person që është zyrtar i bankës, ose çdo person tjetër juridik, duke përfshirë çdo anëtar të Bordit drejtues ose të Komitetit të Kontrollit Financiar dhe çdo person i cili vetëm ose së bashku me një apo më tepër persona ka autoritet të hyjë në marrëveshje për llogari të bankës apo të personit juridik;

“filial” i një banke apo personi tjetër juridik nënkupton një ent në varësi të kësaj banke apo të personit juridik, ose kompani nga e cila kjo bankë ose personi juridik është e varur, apo një kompani që është nën kontroll të përbashkët me këtë bankë ose person juridik;

“bankë” nënkupton një person juridik i angazhuar në aktivitetin e pranimit të depozitave në Kosovë si entitet vendas ose si degë e ndonjë banke të huaj dhe të përdorimit të këtyre fondeve, tërësisht apo pjesërisht, për dhënie e kredive ose të investimeve me rrezik për veten e vet;

“degë” nënkupton një vend të aktivitetit afarist i cili formon një degë ligjërish të varur të një banke, e

pathemeluar më vete dhe e cila kryen drejtpërdrejt të gjitha ose disa nga veprimtaritë financiare të bankës;

“kapital” nënkupton vlerën neto të fondeve të një banke që është diferenca ndërmjet aktivës dhe pasivës të saj sipas llogarive të bilancit që pasqyron standardet ndërkombëtare të kontabilitetit ose parime të tjera të shëndosha të kontabilitetit të pranueshme nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave në Kosovë (BPK);

“shpërndarje e kapitalit” nënkupton shpërndarjen e parave të gatshme ose pasurisë tjetër nga një bankë për pronarët e vet, që bëhet në llogari të asaj pronësie, por duke mos përfshirë asnjë dividend, që përbëhen vetëm nga aksionet e institucionit apo nga të drejtat për të blerë këto aksione, ose çfarëdo shume e paguar në depozitat e një banke kooperative që BPK-ja përcakton se nuk është shpërndarje për qëllimet e paragrafit 27.3;

“kredi” do të thotë çdo angazhim direkt apo indirekt për dhënien e një shume parash në këmbim të të drejtës së kthimit të shumës së dhënë dhe të papaguar dhe të pagesës së interesit dhe detyrimeve të tjera mbi atë shumë, çdo shtyrje të afatit të pagesës së borxhit, çdo garanci e lëshuar për pagesën e një borxhi dhe çdo angazhim për të përfutur të drejtën mbi pagesën e një shume parash; termi “kredi” nuk përfshin depozitat bankare dhe blerjen e letrave me vlerë në tregun dytësor;

“dokumentacion i kredisë” nënkupton një marrëveshje kredie të nënshkruar nga një bankë dhe dokumentet e tjera mbështetëse, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në deklaratat më të fundit financiare të huamarrësit apo të cilësdo dorëzani të borxhit të huamarrësit; një dokument të kalimit ose subvencionit të ngjashëm të ngarkuar mbi çdo garanci kolaterale për të cilin huadhënësit i jepet hipoteka, interesi i sigurimit ose barra si siguri për pagesën e huasë dhe një vlerësim i vlerës së kësaj garancie; dhe një dokument të kushteve ku përcaktonen kushtet kryesore të huasë, siç është shuma themelore e huasë së dhënë, përqindja e interesit, afatet e pagesave dhe përdorimi i parave nga huamarrësi dhe qëllimi i huamarrjes;

“sigurim i borxhit” nënkupton çdo instrument të negociueshëm të borxhit dhe çdo instrument tjetër që është ekuivalent me këtë instrument qoftë në formë certifikate apo regjistrimi në librin e regjistrimeve;

“depozitë” nënkupton shumën e parave të paguara në bankë, me kusht që banka ta ripaguajë plotësisht atë shumë, me apo pa interes ose prim, qoftë si llogari rrjedhëse apo si depozitë me afat dhe që nuk i referohet dispozitës së pronës, shërbimeve ose dhënies së sigurimit, pavarësisht nëse është regjistruar në ndonjë dokumentacion të bankës ose vërtetohet me faturë, certifikatë, shënim a ndonjë dokument tjetër;

“pjesëmarrje aksionere” nënkupton çdo të drejtë pronësie a votimi të një personi juridik ose ndërmarrjeje;

“veprimtari financiar” nënkupton secilën nga veprimtaritë e numëruara në nenin 25;

“institucion financiar” nënkupton personin juridik që nuk është bankë e që është licencuar nga BPK-ja për t’u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë vijuese: dhënien e kredive, nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë, veprimin si menaxher i kompanisë së investimeve ose këshilltar i investimeve a ofrimin e shërbimeve të tjera financiare siç janë: shërbimet financiare për dhënien me qira të pajisjeve, shërbimet mikrofinanciare, këmbimi valutë ose shërbime të tjera financiare, informative, këshillëdhënëse dhe operacionale;

“direktiva” nënkupton rekomandimet jodetyruese që u jepen bankave, institucioneve financiare, ose një banke a institucioni financiar të caktuar;

“licencë” nënkupton autorizimin e lëshuar nga BPK-ja dhe dhënien e të drejtës për t’u marrë me veprimtari bankare a financiare që janë të përcaktuara në atë licencë;

“urdhresë” nënkupton një direktivë detyruese të BPK-së, që nxirret për një bankë, institucion financiar ose një grupi të tillë të posaçëm për zbatimin e kësaj rregulloreje a të një rregulli;

“person” nënkupton individin, kompaninë, ndërmarrjen, ortakërinë, shoqatën dhe çfarëdo grupi personash që veprojnë së bashku qofshin të themeluar apo jo;

“akcionar kryesor” nënkupton personin që posedon në mënyrë direkte apo indirekte dhjetë për qind ose më tepër të çfarëdo klase të aksioneve me të drejtë vote të një banke ose kompanie;

“ kapital rregullator” nënkupton kapitalin e përcaktuar herë pas herë nga BPK-ja për qëllime rregullatore;

“masa përmirësuese” nënkupton masat për të korrigjuar shkeljet e përshkruara në nenin 37;

“rregull” nënkupton një direktivë detyruese për zbatimin e kësaj rregulloreje të nxjerrë nga BPK-ja për të gjitha bankat dhe institucionet financiare;

“interes i konsiderueshëm” nënkupton posedimin direkt apo indirekt të një interesi në një person juridik ose ndërmarrje, që përfaqëson njëzet për qind apo më tepër të aksioneve me të drejtë vote, ose që, sipas mendimit të BPK-së, jep mundësi për ushtrimin e një ndikimi kontrollues mbi menaxhimin ose politikat e tij;

“ndërvarësi” nënkupton çdo person juridik në të cilin një person tjetër ose grup personash që veprojnë së bashku mban direkt apo indirekt pesëdhjetë për qind ose më tepër të çfarëdo klase të aksioneve me të drejtë vote ose një interes të konsiderueshëm, që i mundëson këta persona të tjetër ose grup personash të ushtrojnë një ndikim kontrollues në menaxhimin ose politikat e personit të varur dhe

“aksione me të drejtë vote” nënkupton aksione të zakonshme në kapitalin e emetuesit dhe aksione të tjera të çfarëdo caktimi ose përshkrimi, që i japin emetuesit të drejtën për të votuar për çfarëdo vendimi në një mbledhje të zakonshme ose speciale.

Neni 3

NDALESAT DHE PËRJASHTIMET

3.1 Asnjë person nuk mund të merret me veprimtari të një banke apo institucioni financiar pa licencë të vlefshme të lëshuar nga BPK-ja.

3.2 Asnjë person nuk mund të përdorë fjalën "bankë" ose derivatet e fjalës "bankë" në lidhje me një veprimtari, produkt ose shërbim pa pasur një licencë të lëshuar nga BPK-ja, përveç kur një përdorim i tillë është vendosur ose njohur me këtë rregullore, një marrëveshje ndërkombëtare, ose kur konteksti në të cilin është përdorur fjala "bankë" nuk ka të bëjë me veprimtari financiare.

3.3 Asnjë bankë ose institucion financiar nuk mund të përdorë në emrin e vet fjalë që mund të çojnë në keqkuptime lidhur me kushtet e tyre financiare, statusin ligjor ose lidhjen me qeverinë a me institucionet ndërkombëtare.

3.4 Asnjë bankë ose institucion financiar i organizuar jashtë Kosovës nuk lejohet të angazhohet direkt në çfarëdo veprimtari financiare në Kosovë përveç nëse një veprimtari e tillë ndërmerret nëpërmjet një dege a kompanie të varur për të cilën BPK-ja ka lëshuar licencë.

3.5 Asnjë person nuk duhet të bëjë deklarime të rreme për fakte materiale ose të bëjë një paraqitje të

rreme ose çorientuese apo të bëjë çdo gjë për të krijuar një pamje të rreme, mashtruese ose të angazhohet në çfarëdo veprimi manipulues për përvetësim të depozitave.

3.6 BKP-ja mund të përjashtojë tërësisht ose pjesërisht nga zbatimi i kësaj rregulloreje, bankat për të cilat marrja e depozitave ka për qëllim nxitjen e kursimeve financiare nga grupe të identifikuar personash, pasivet totale të llogarisë së të cilëve nuk e tejkalojnë shumën 250.000 DM, me kusht që asnjëra prej këtyre bankave të mos përdorë fjalën "bankë" në emrin e tyre.

LICENCIMI I BANKAVE

Neni 4

PËRGJEGJËSIA E BPK-së PËR DHËNIEN E LICENCAVE

BPK-ja ka përgjegjësi ekskluzive për dhënien e licencave për bankat dhe institucionet financiare.

Neni 5

MINIMUMI I KAPITALIT

BPK-ja ka përgjegjësi ekskluzive për përcaktimin e shumës së kërkuar të minimumit të kapitalit paguar për t'u mbajtur nga bankat. Kjo shumë e kërkuar në asnjë rast nuk mund të jetë më e vogël se një milion DM. BPK-ja mund ta rrisë këtë shumë të kërkuar herë pas here me rregull ose urdhresë.

Neni 6

KËRKESA PËR LICENCË

6.1 Kërkesa për licencë bëhet në një formular që e përcakton BPK-ja dhe duhet shoqëruar me informacionin e mëposhtëm:

- (a) Kualifikimet dhe përvojën e administratorëve të një banke ekzistuese ose të propozuar, duke përfshirë historinë e veprimtarisë dhe atë profesionale për dhjetë vitet e fundit;
- (b) Shumën e kapitalit ekzistues ose të propozuar të bankës dhe për bankat e propozuara shumën që mund të jetë parapaguar ose nënshkruar, me kusht që jo më tepër se 10% e kapitalit të bankës të mund të kontribuohet në natyrë;
- (c) Planin e veprimtarisë të përcaktuar, ndër të tjera, strukturën organizative, llojin e parashikuar të veprimtarive financiare, deklaratat e parashikuara financiare për tre vjet dhe për bankat ekzistuese, deklaratat financiare dhe raportet vjetore për dy vitet e fundit;
- (d) Emrin, selinë, historinë e veprimtarisë dhe aftësisë profesionale për dhjetë vitet e fundit dhe deklaratat financiare për tri vitet e fundit për çdo person që është ose propozohet të jetë kryesor, apo që ka a propozohet të ketë interes të konsiderueshëm në bankë si dhe shumën dhe përqindjen për të; interesat e propozuara të pronësisë së personave që do të jenë filial ose të lidhur mblidhet për të përcaktuar shumën e këtij interesi; dhe
- (e) Informacion tjetër shtesë që kandidati për licencë e konsideron të përshtatshëm.

6.2 BPK-ja mund të kërkojë që kandidati për licencë të dorëzojë informacion plotësues ose shtesë.

6.3 Kërkesa për licencë për një degë të një banke të huaj me drejtori të përgjithshme në juridiksion të ndryshëm nga ai i Kosovës (që më poshtë do të quhet "bankë e huaj") duhet të dorëzohet nga banka e huaj, duke i bashkëngjitur informacionin e kërkuar nga BPK-ja.

Neni 7

VENDIMI PER LICENCË

7.1 Brenda tre muajsh nga data e pranimit të kërkesës së plotësuar për licencë për bankë, BPK-ja paraprakisht e miraton ose refuzon atë dhe njofton me shkrim kandidatin për vendimin e saj; njoftimi për refuzimin e një kërkesë duhet të shoqërohet me arsyet e refuzimit të licencës.

7.2 BPK-ja jep licencë vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- (a) Nëse plani i veprimtarisë bazohet në analiza të sakta mbi supozime të arsyeshme;
- (b) Nëse banka pajtohet me të gjitha dispozitat e kësaj rregulloreje; dhe
- (c) Nëse kualifikimet, përvoja dhe figura morale e administratorëve, aksionerëve kryesorë dhe e atyre që propozojnë të kenë ose kanë interes të konsiderueshëm janë të përshtatshme për planin e veprimtarisë së bankës dhe për veprimtaritë financiare të saj.

7.3 Në rast të miratimit paraprak të një kërkesë për licencë banke, BPK-ja përcakton kushtet e nevojshme për bankën së cilës i jepet licenca për të filluar operacionet e saj. Këto kushte lidhen vetëm me:

- (a) Pagesën e kapitalit fillestar që aksionerët duhet të bëjnë për bankën;
- (b) Punësimin dhe trajnimin e personelit të bankës;
- (c) Marrjen me qira ose blerjen e pajisjeve operative dhe përcaktimin e sistemeve operative, duke përfshirë edhe kontrollin e brendshëm financiar dhe inspektimet;
- (d) Marrjen me qira, blerjen ose zotërimin e lokaleve të bankës dhe
- (e) Angazhimin e një kontrollori financiar të jashtëm në përputhje me nenin 33.

7.4 Nëse brenda një viti një bankë nuk vepron në përputhje me kushtet për marrjen e licencës për fillimin e veprimtarisë, miratimi paraprak i kërkesës revokohet.

7.5 BPK-ja vendos të japë licencën nëse ajo mendon që kushtet e përcaktuara në këtë nen janë përmbushur.

7.6 Licencat për një subjekt të varur ose një a më tepër degë të një banke të huaj jepet vetëm në qoftë se:

- (a) Banka e huaj është e autorizuar të angazhohet në veprimtarinë e pranimit të depozitave ose depozitave si fonde në juridiksionin e vendit të huaj ku është e vendosur drejtoria e saj qendrore;
- (b) Organet kompetente që mbikëqyrin bankën e huaj në drejtorinë e saj qendrore kanë dhënë pëlqimin me shkrim për dhënien e kësaj licence; dhe
- (c) BPK-ja vendos që banka mbikëqyret ashtu si duhet mbi baza të konsoliduara nga autoritetet e saj

mbikëqyrëse.

Neni 8 LICENCA

8.1 Licenca jepet për një periudhë të pacaktuar kohe dhe nuk është e transferueshme. Pas dhënies së licencës, bankat e autorizuara në mënyrë të rregullt mund të kërkojnë nga BPK-ja që të angazhohen në aktivitete shtesë. BPK-ja mund të miratojë kërkesën e tyre ose jep arsyet me shkrim për refuzimin e saj.

8.2 BPK-ja mund të vendosë tarifa për shqyrtimin e një kërkesë për licencë, dhënien e licencës, si dhe për posedimin e saj. Të gjitha këto tarifa janë të pakthyeshme.

Neni 9 REGJISTRI I BANKAVE

BPK-ja mban një regjistër qendror për inspektim nga publiku që për çdo bankë të licencuar përmban emrin, adresën e drejtorisë qendrore të degëve të bankës dhe kopjet aktuale të statutit të saj ose dokumente ekuivalente të krijimit. Një listë e bankave, licencat e të cilave janë revokuar, duhet mbajtur në regjistër, por dokumentet e tyre të themelimit hiqen nga regjistri.

Neni 10 REVOKIMI I LICENCËS

- 10.1 Licenca e një banke mund të revokohet vetëm me vendim të BPK-së, me kërkesë të bankës, për shkelje të përcaktuara me nenin 37 më poshtë ose për një a më shumë prej këtyre arsyeve: stream
- (a) Nëse licenca është marrë në bazë informacioni të rrejshëm të paraqitur nga kërkuesi;
 - (b) Nëse banka nuk ka filluar të funksionojë brenda nëntëdhjetë ditësh pas marrjes së licencës apo brenda një periudhe të vijuese të caktuar nga BPK-ja dhe nëse ka pushuar të merret me veprimtarinë e marrjes së depozitave për më shumë se tetë muaj;
 - (c) Nëse një bankë tjetër, që mban një interes të konsiderueshëm në këtë bankë, i është revokuar licenca;
 - (d) Nëse ka ndodhur bashkimi, shkrirja ose shitja e pjesës më të madhe të pasurisë së bankës;
 - (e) Nëse pronari ose pronarët e bankës kanë vendosur të shpërndajnë apo ta likuidojnë bankën, nëse banka ka pushuar së ekzistuari ligjërisht ose funksionalisht si ent i pavarur;
 - (f) Nëse aktivitetet e bankës gjatë tri viteve të para të veprimtarisë ndryshojnë në thelb nga ato të paraqitura në kërkesën për licencë dhe, sipas mendimit të BPK-së, ky ndryshim nuk është i justifikuar dhe
 - (g) Nëse një bankë e huaj nuk ka autoritet ose e ka humbur autoritetin për t'u angazhuar në veprimtarinë e pranimit të depozitave në vendin ku është vendosur drejtoria e saj qendrore.

10.2 Vendimi i BPK-së për të revokuar ose për të mos revokuar një licencë i komunikohet me shkrim çdo banke ose dege përkatëse, duke dhënë arsyet e vendimit i cili hyn në fuqi në ditën e komunikimit.

Neni 11

PUBLIKIMI I REVOKIMIT TË LICENCËS

Vendimi për revokimin e një licence publikohet në një ose më shumë gazeta me qarkullim të përgjithshëm kudo që gjenden degët e bankës.

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I BANKAVE

Neni 12

ORGANIZIMI DHE PAVARËSIA E BANKAVE

12.1 Bankat sipas legjislacionit në fuqi organizohen si shoqëri aksionere me përgjegjësi të kufizuar dhe me të gjitha aksionet e regjistruara në emër të pronarëve të tyre përfitues.

12.2 Dispozitat e legjislacionit në fuqi për ndërmarrjet, shoqëritë dhe bankat zbatohen në masën që nuk bien në kundërshtim me këtë rregullore. Megjithatë, regjistrimi në gjykatë nuk është kusht për fillimin e veprimtarisë bankare pas marrjes së licencës nga banka.

12.3 Çdo bankë gëzon autonomi administrative, financiare, operative dhe ligjore nga çdo person tjetër duke përfshirë edhe BPK-në dhe çdo agjenci, instrument ose seksion politik të qeverisë, përveç kur ligji, kjo rregullore ose rregullat dhe urdhresat e nxjerra në përputhje me të vendosin ndryshe. Kjo autonomi duhet të respektohet dhe asnjë person nuk ka të drejtë të ushtrojë ndikim mbi çdo administrator banke në kryerjen e detyrave të tij/saj ose të ndërhyjë në veprimtaritë e bankave, përveç për zbatimin e një direktive ose detyre të veçantë në bazë të ligjit.

12.4 Çdo bankë ka status ligjor që përfshin të drejtën për të kontraktuar, për të pasur në pronësi dhe shitur pasuri të tundshme dhe të patundshme dhe mund të jetë palë në procedura ligjore.

Neni 13

KËRKESAT PËR KAPITAL

Shuma minimale që duhet të mbajnë bankat si kapital rregullator dhe shuma absolute minimale e kapitalit duhet përcaktuar herë pas here me rregull ose urdhresë.

Neni 14

KUFIZIMET NË PRONËSI DHE NË AKSIONE

14.1 Transferimi i një pjesëmarrjeje e në një bankë kërkon autorizim paraprak me shkrim nga BPK-ja nëqoftëse si rezultat i këtij transferimi ndonjë person ose një numër personash që veprojnë së bashku, në mënyrë direkte ose indirekte, do të bëheshin aksionerë të konsiderueshëm në këtë bankë ose do të posedonin më shumë se njëzet për qind të çfarëdo lloji të aksioneve me të drejtë vote të bankës. Përcaktimet e BPK-së duhet të bazohen në kriteret e përshkruara në nenin 7 dhe në faktorë të tjerë që BPK-ja mund t'i gjykojë të arsyeshme.

14.2 Asnjë bankë, vetëm ose në bashkëpunim me një ose më shumë persona, pa autorizim paraprak me

shkrim nga BPK-ja, nuk mund të posedojë direkt ose indirekt, pjesëmarrje aksionere të një personi juridik ose sipërmarrjeje që merret me veprimtari të ndryshme nga ajo financiare e cila përfaqëson një interes të konsiderueshëm ose vlera neto e saj tejkalon ekuivalentin e pesëmbëdhjetë për qind të kapitalit rregullator të bankës apo lejon që shumta e vlerës neto të gjithë kësaj pjesëmarrjeje aksionere të tejkalojë ekuivalentin e njëqind për qind të kapitalit rregullator të bankës.

14.3 Pavarësisht nga paragrafi 14.2, nuk kërkohet asnjë autorizim për:

- (a) Pjesëmarrjet aksionere që janë fituar nga një bankë me hipotekë ose nga barra e vënë për të shlyer një kredi të dhënë nga banka, dhe në këtë rast banka duhet të shesë këtë pjesëmarrje aksionare brenda një viti nga data që ajo u fitua ose brenda një periudhe më të gjatë kohe që BPK-ja mund të lejojë dhe
- (b) Pjesëmarrjet aksionare të mbajtura nga banka si agjent ose dorëzënës.

Neni 15

BASHKIMI I BANKAVE

Bashkimi, shkrirja ose shitja e pjesës më të madhe të aktivës të një banke kërkon autorizimin paraprak me shkrim nga BPK-ja. Vendimet bazohen në faktin nëse transaksionet e propozuara do të rezultojnë në dobësim të ndjeshëm të konkurrencës në tregun e shërbyer nga banka dhe në kriteret e përcaktuara në nenin 7.

Neni 16

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

16.1 Çdo bankë ka një statut ose dokument ekuivalent të themelimit që specifikojnë emrin dhe adresën e themelimit; qëllimet e saj; juridiksionin dhe kompetencat e Bordit të saj drejtues; shumën e kapitalit të saj, klasat, numrin dhe vlerën nominale të aksioneve të saj dhe të drejtat e votimit bashkëngjitur aksioneve të saj. Asnjë ndryshim dhe plotësim i statutit ose i dokumenteve ekuivalente të themelimit të një banke nuk hyn në fuqi pa miratimin paraprak me shkrim të BPK-së.

16.2 Çdo bankë drejtohet sipas statutit të miratuar nga Bordi drejtues, i cili në përputhje me statutin vendos:

- (a) Strukturën e organizimit dhe të administrimit të bankës duke përfshirë këtu edhe njësitë e saj operative dhe administrative, nën-njësitë dhe funksionet e tyre, funksionet mbikëqyrëse dhe marrëdhëniet raportuese.
- (b) Detyrat e çdo drejtori të departamentit dhe njësitë nën mbikëqyrjen e tij/saj.
- (c) Funksionet e Komitetit të kontrollit financiar, të Komitetit të menaxhimit të riskut të huave, Komitetit të menaxhimit të aktivës dhe pasivës dhe të komiteteve të tjera të përhershme të Bordit drejtues dhe
- (d) Kufizimet e autoritetit të administratorëve dhe punonjësve të bankës për ta detyruar bankën me kontratë.

16.3 Çdo bankë mban në BPK në dosje një kopje të vërtetuar të statutit apo dokumentet ekuivalente të themelimit, aktet e saj nënligjore dhe listën e punonjësve të bankës bashkë me ekzemplarin e nënshkrimeve dhe

përshkrimin e kufizimeve të kompetencave të tyre, të cilët aktualisht janë të autorizuar ta detyrojnë bankën t'i kryejë punët përkatëse.

Neni 17

ORGANET DREJTUESE TË BANKAVE

17.1 Çdo bankë administrohet nga një Bord drejtues i përbërë nga numri tek prej jo më pak se pesë anëtarësh, prej të cilëve dy janë drejtorë joekzekutivë dhe ka një Komitetit të kontrollit financiar, një Komitet të menaxhimit të riskut të huave dhe një Komitet të menaxhimit të aktivës dhe pasivës.

17.2 Bordi drejtues zgjedhet nga aksionerët e bankës dhe është përgjegjës për përcaktimin e politikave të saj dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre politikave.

17.3 Bordi drejtues emërohet nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve me mandat jo më shumë se dy vjet dhe mund të riemërohen për periudha të njëjta vijuese. Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve mund të caktojë kompensim për anëtarët e Bordit me kusht që kompensimi i Bordit drejtues dhe personelit të lartë drejtues të bankës të miratohet nga BPK-ja për tri vitet e para të veprimtarisë së bankës, ose nëse është e nevojshme, edhe më gjatë sipas gjykimit të BPK-së.

17.4 Bordi drejtues vepron në përputhje me dokumentet e themelimit të bankës.

17.5 Bordi drejtues dhe anëtarët e tij nuk mund t'ua delegojnë përgjegjësitë e tyre të tjerëve.

-

Neni 18

ADMINISTRATORËT

Të gjithë personat e zgjedhur ose të emëruar si administratorë të një banke duhet të jenë të aftë dhe të përshtatshëm, me emër të mirë dhe duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga BPK-ja lidhur me kualifikimet, përvojën dhe figurën e pastër morale. Para marrjes së detyrës, anëtarëve të Bordit drejtues duhet t'u jepet pëlqimi nga BPK-ja.

Neni 19

ADMINISTRATORËT DHE AKSIONARËT KRYESORË; DISKUALIFIKIMI DHE SHKARKIMI

19.1 Një person nuk ka të drejtë të jetë anëtar i Bordit drejtues të një banke nëse me vendim të mbledhjes së përgjithshme a speciale të akcionarëve të bankës shkarkohet nga anëtarësia e tij/saj në Bordin drejtues, ose në qoftë se nuk vepron brenda 30 ditësh nga njoftimi për diskualifikim, shkarkohet nga BPK-ja, në rast se:

- (a) Me ligj i është hequr i është hequr e drejta për të marrë pjesë në Bordin drejtues të një personi juridik;
- (b) Shërben ose ka shërbyer në çfarëdo kohe gjatë dymbëdhjetë muajve të mëparshëm në BPK;
- (c) Është dënuar për vepër penale;
- (d) Sipas gjykimit të BPK-së ka qenë palë në një transaksion që shkel këtë rregullore ose ndonjë rregull apo urdhresë ose

(e) Ka qenë subjekt i një procedure falimentimi si debitor

19.2 Anëtarët e Bordit drejtues, përveç atyre që kanë dorëzuar një vërejtje me shkrim kundër dhënies së ndonjë huaje, janë përgjegjës bashkarisht dhe individualisht për humbjet që pëson banka nga dhënia e kredive në kundërshtim me nenet 23, 27 ose 30. Këto detyrime mund të mos paguhen direkt ose indirekt nga banka apo ndonjë nga filialet e saj që ata i shërbejnë ose nga fitimet që rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësisë profesionale ose nga ndonjë politikë tjetër e zhdëmtimit të bankës.

19.3 Një person fizik që është aksionar kryesor i një banke ose aksionar kryesor i një filiali të një banke, menjëherë pas diskualifikimit tërheq pjesëmarrjen e tij/saj nga aksionet me të drejtë vote të kësaj banke ose filiali në një nivel më poshtë se ai i aksionerit kryesor. Nëse ai/ajo nuk e bën këtë gjë brenda 60 ditësh nga dita e diskualifikimit, këto aksione humbasin të drejtën e votimit dhe marrin një shpërndarje kapitali. Pas kësaj periudhe nëse heqja e të drejtës së votimit nuk bëhet brenda 60 ditëve, BPK-ja mund të urdhërojë që të gjitha aksionet në bankë, të mbajtura në mënyrë direkte ose indirekte nga ky aksionar kryesor, të transferohen në një dorëzani për shitje në ankand dhe të ardhurat neto, pas heqjes së shpenzimeve të shitjes, i paguhet aksionarit të diskualifikuar.

-

Neni 20

KOMITETET

20.1 Çdo bankë duhet të krijojë një komitet të kontrollit financiar që përbëhet nga të paktën dy anëtarë joekzekutivë të Bordit drejtues. Komiteti i kontrollit financiar ka për detyrë të:

- (a) Bëjë kontrole të brendshme të përshtatshme kontabiliteti, të bëjë kontrole operacionale dhe administrative, të mbikëqyrë pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat, të autorizojë kontrole financiare, me shpenzimet e bankës, për regjistrimet e bankës;
- (b) Kontrollon pajtueshmërinë me këtë rregullore dhe rregullat e urdhresat në fuqi dhe i raporton Bordit drejtues për këtë çështje;
- (c) Angazhohet ekspertë me shpenzimet e bankës për të ndihmuar në përmbushjen e përgjegjësisë të komitetit dhe
- (d) Jep mendime për çdo çështje që i parashtrohet atij nga Bordi drejtues ose që dëshiron vetë ai ta shqyrtojë.

20.2 Komiteti i kontrollit financiar takohet një herë në tre muaj dhe kur thirret nga Bordi drejtues ose nga dy prej anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Procesverbalet e mbledhjeve mbahen në mënyrën e përcaktuar nga BPK-ja.

20.3 Çdo bankë formon një Komitet të menaxhimit të riskut të huave dhe një Komitet të menaxhimit të aktivës dhe pasivës dhe secilin prej këtyre e zgjedh Bordi Drejtues nga radhet e anëtarëve të lartë të kualifikuar.

20.4 Komiteti i menaxhimit të riskut të huave duhet të:

- (a) Takohet një herë në javë ose sa herë të paraqitet nevoja, sipas procedurave të përcaktuara në statut;
- (b) Përcakton dhe kontrollon zbatimin e politikave dhe të procedurave për dhënien e kredive,

administrimin e huave dhe pagimin e huave;

- (c) Kontrollon pajtueshmërinë me këtë rregullore dhe me rregulla e urdhresa të tjera në fuqi për kredinë dhe i raporton për këtë çështje Bordit drejtues dhe
- (d) Jep mendime për çdo çështje që i parashtrohet atij nga Bordi drejtues ose që dëshiron vetë Komiteti ta shqyrtojë.

20.5 Komiteti i menaxhimit të aktivës dhe pasivës duhet të:

- (a) Takohet një herë në muaj sa herë që thirret nga Bordi drejtues apo nga dy prej anëtarëve të tij në përputhje me statutin;
- (b) Të marrë vendime me shumicë votash të anëtarëve që janë të pranishëm dhe
- (c) Të përcaktojë dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe të procedurave për parashikimin e nevojave për fonde dhe përpunjen e duhur të maturimeve të aktivës dhe pasivës.

Neni 21

SEKRETI

Administratorët e tashëm dhe të mëhershëm, nëpunësit dhe agjentët e një banke ose të një institucioni financiar, si ata që kanë punuar ashtu edhe ata që aktualisht punojnë, duhet të mbajnë sekret dhe të mos e përdorin për përfitim personal a përfitim të tjerëve, përveç përfitimit të bankës në të cilën kanë shërbyer ose shërbejnë, të mos lejojnë shqyrtimin e informacionit të pabotuar nga persona të tjerë, të cilin e kanë arritur gjatë kryerjes së detyrave të tyre në bankë. Një informacion i tillë mund t'i bëhet i ditur vetëm BPK-së, duke përfshirë këtu inspektorët e saj dhe ekspertët kontabël të caktuar prej saj, ekspertët kontabël të jashtëm të bankës, organet gjyqësore sipas përcaktimeve me ligj, autoritetet mbikëqyrëse të bankave të huaja edhe atëherë kur mbrojtja e interesave të bankës në një procedurë gjyqësore kërkon të zbulohet informacioni.

Neni 22

PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE

22.1 Asnjë bankë ose institucion financiar nuk duhet të fshehë, të këmbejë ose të transferojë para a pasuri tjetër, në qoftë se ajo di ose duhet të ketë dijeni që këto para ose kjo pasuri tjetër burojnë nga aktiviteti kriminal dhe as të ndihmojë ose nxisë cilindo person për të fshehur ose maskuar origjinën e paligjshme të parave a të pasurisë.

22.2 Bankat dhe institucionet financiare duhet të informojnë BPK-në për çdo provë që tregon se pasuria mund të rrjedhë nga aktivitetet kriminal edhe t'u japë autoriteteve përkatëse çdo informacion shtesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 23

KONFLIKTI I INTERESAVE DHE DETYRIMET E BESNIKËRISË

23.1 Administratori i një banke apo institucioni financiar, i cili është palë e një kontrate materiale ose e një kontrate të propozuar materiale me bankën ose që është administrator, a që ka interes material ose një marrëdhënie materiale me një person që është palë në një kontratë materiale a në një kontratë të propozuar

materiale me bankën, duhet t'ia bëjë të ditur me shkrim bankës natyrën dhe shkallën e interesit ose të marrëdhënies materiale. Një zbulim i tillë duhet të bëhet nga ana e administratorit atëherë kur kontrata ose kontrata e propozuar i bëhet e ditur a duhet t'ia jetë bërë e ditur administratorit, brenda arësyes.

23.2 Një njoftim me shkrim e një administratori drejtuar Bordit drejtues të bankës që bën të ditur çdo vit emrat, adresat dhe hollësitë e këtyre veprimtarive materiale, tregtare, financiare, bujqësore, industriale e të tjera, ose interesat familjare që ky person ka në atë periudhë, është një deklaram i mjaftueshëm i konfliktit të interesit për çfarëdo kontrate për qëllimet e nenit 23.1

23.3 Një administrator i cili ka interes material ose marrëdhënie materiale brenda fushës së veprimit të këtij neni, duhet të mos marrë pjesë në mbledhjet ku diskutohet për kontratën ose kontratën e propozuar, dhe duhet të mos marrë pjesë në votim për të gjitha këto çështje që shtrohet në Bordin drejtues të bankës.

23.4 Një interes është material nëse është i rëndësishëm në lidhje me interesin financiar të veprimtarisë ekonomike ose interesat familjare (çdo person që është i lidhur me martesë ose në lidhje gjaku të shkallës së dytë) të personit që ka interes dhe një person ka interes material në një kompani nëse personi zotëron, direkt ose indirekt, një interes të konsiderueshëm në atë kompani ose është administrator i kompanisë dhe ka një interes të konsiderueshëm në çfarëdo ortakërie nëse personi është ortak.

23.5 Nëse një administrator nuk zbulon një konflikt interesi material në përputhje me këtë nen, një gjykatë e juridiksionit kompetent, me kërkesën e bankës, të një aksionari të bankës ose të BPK-së, e anulon kontratën në mënyrën që mendon se është e përshtatshme. Përveç kësaj, BPK-ja, sipas urdhërit me shkrim, mund ta pezullojë administratorin nga detyra për një periudhë më pak se një vit, ose ta shkarkojë përfundimisht atë nga detyra.

23.6 Bankat duhet të fusin në zbatim marrëveshje dhe procedura të përshtatshme në mënyrë që ato, administratorët dhe nëpunësit, të mos vihen në situata kur detyra e tyre ndaj një klienti bie në kundërshtim me detyrat e tyre ndaj një klienti tjetër, ose kur interesat e tyre vetiake bien në kundërshtim me detyrat e tyre ndaj një klienti.

23.7 Administratorët dhe punonjësit e bankave kanë një detyrim të pavarësisë, besnikërisë dhe maturisë ndaj bankës që ata i shërbejnë dhe ndaj depozituesve të bankës për të vënë interesat e bankës para interesave të tyre vetiake.

23.8 Asnjë bankë nuk i jep kredi filialit të saj me kushte preferenciale sa i përket llojit të kredisë, përqindjes së interesit, tarifës, afatit të maturimit ose vlerës së kolateralit dhe as nuk mund blejë ndonjë aktivë nga ndonjë filial në formën e huasë që nuk paguhet.

23.9 Asnjë bankë nuk i jep kredi të pambuluar me kolateral ose hipotekë asnjërës nga filialet e saj në shuma që tejkalojnë 10% të kapitalit minimal rregullator përveç me autorizim paraprak me shkrim nga BPK-ja; dhe

23.10 Asnjë bankë nuk duhet të ketë njëkohësisht kredi të papaguara të dhëna gjithë filialeve të saj në shumën që tejkalon 25% të totalit të kapitalit të saj minimal rregullator, përveç me autorizim me shkrim nga BPK-ja.

KËRKESAT OPERACIONALE

Neni 24

PARIMET E PËRGJITHSHME

-

24.1 Bankat kryejnë administrimin dhe operacionet e tyre në përputhje me politikat dhe procedurat e shëndosha, me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe me rregullat dhe urdhresat në fuqi.

24.2 Bankat mbajnë atë kapital për të mbuluar risqet dhe mbajnë ato aktive likuide që përcaktohen me rregull.

24.3 Bankat duhet të sigurojnë diversitet të aktivës me risk si përcaktohet me rregull.

-

-

Neni 25

AKTIVITETET FINANCIARE

25.1 Në licencat e tyre bankat autorizohen për t'u angazhuar në veprimtari financiare të përcaktuara në këtë nen.

25.2 Bankat me shumën minimale të kapitalit të kërkuar në përputhje me nenin 5, dhe të ndryshuar herë pas here, mund të angazhohen në veprimtari të mëposhtme financiare:

- (a) Pranimin e depozitave (në formën e llogarisë rrjedhëse, depozitave me afat ose në forma të tjera depozite) me ose pa interes në një valutë;
- (b) Blerjen dhe shitjen për llogari të bankës të letrave me vlerë të emetuara ose të garantuara nga qeveritë ose bankat qendrore të Bashkimit Europian të denominuara dhe të pagueshme në valutën e depozitave të bankës dhe që kanë afat maturimi më pak se një vit;
- (c) Ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe arkëtimit;
- (d) Emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesave (duke përfshirë kartat e pagesave, çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankës);
- (e) Blerjen dhe shitjen e valutës së huaj në kesh për llogari të klientit;
- (d) Ofrimin e shërbimit të ruajtjes së letrave me vlerë dhe sendeve të tjera të çmueshme dhe
- (e) Veprimtari të tjera financiare që BPK-ja përcakton me rregull.

25.3 Bankat që kanë kapital deri në tre milionë DM, ose shuma më të mëdha, që mund të caktohen kohë pas kohe me rregullore ose urdhresë, mund të angazhohen në veprimtari financiare të përcaktuara në nenin 25.2 dhe, përveç kësaj, edhe në veprimtari të mëposhtme financiare:

- (a) Pranimin e depozitave me ose pa interes në më shumë se një valutë;
- (b) Dhënie e kredive, duke përfshirë kreditë konsumuese dhe hipotekare; blerjen dhe shitjen e arkëtimit të pritshme me ose pa të drejtë tërheqjeje të parave dhe financimin e transaksioneve tregtare;
- (c) Marrjen hua të fondeve dhe blerjen e shitjen për llogari të bankës ose për llogari të klientëve (përveç nënshkrimit) të instrumenteve të tregut të parasë (duke përfshirë kartmonedhat, kambialet

dhe certifikatat e depozitave); blerjen e letrave me vlerë; kontratat e të ardhmes ose ato opsionale lidhur me letrat me vlerë ose përqindjen e interesit, apo instrumentet e përqindjes së interesit;

- (d) Komisionimin e parave;
- (e) Lizingun financiar;
- (f) Ofrimin e shërbimeve për informacion rreth kredive;
- (g) Ofrimin e shërbimeve të agjentit ose këshilltarit financiar (pa përfshirë shërbimet e përcaktuara në paragrafët 25.4 (a) dhe (b); dhe
- (ë) Operimin me një ose me më shumë valuta në vend të valutës në të cilën është denominuar bilanci i bankës, duke përfshirë këtu kontratat ardhshme për blerje dhe shitje të valutave të huaja.

25.4 Bankat që kanë kapital deri në pesë milionë DM, ose shuma më të mëdha, ashtu siç mund të caktohet kohë pas kohe me rregullore ose urdhresë, mund të angazhohen në veprimtari financiare të përcaktuara në nenin 25.2 dhe 25.3, por edhe në veprimtaritë e mëposhtme financiare:

- (a) Ofrimin e shërbimeve trust, duke përfshirë investimin dhe administrimin e fondeve të pranuar në trust dhe administrimin e letrave me vlerë;
- (b) Ofrimin e shërbimeve si menaxher i portofolit të investimit ose këshilltar për investime;
- (c) Nënshkrimin dhe shpërndarjen e borxhit dhe pjesëmarrjes me letra me vlerë me çmim fiks dhe operacionet me këto letra me vlerë dhe
- (d) Në veprimtari të tjera financiare që kanë të bëjnë me transaksionet e letrave me vlerë ashtu siç përcaktohet me rregullore nga BPK-ja.

25.5 Asnjë bankë ose institucion financiar nuk angazhohet në veprimtari financiare, përveç atyre të cilat janë në mënyrë të poshme janë autorizuar me licencë.

Neni 26

TRANSAKSIONET DHE PRAKTIKAT E NDALUARA

26.1 Bankat dhe institucionet financiare ndalohen të hyjnë në transaksione ose të angazhohen në praktika të çdo lloji që do t'u jepnin atyre, vetëm apo së bashku me të tjerë, një pozicion zotërues në tregjet e parasë, kapitalit ose këmbimit valutor, dhe në angazhime në mjete manipuluese ose praktika të çmimeve grabitqare që mund të rezultojnë në një avantazh të pandershëm për ata vetë ose për palë të treta.

26.2 Asnjë bankë nuk i kërkon një personi që të kontraktojë për të përftuar shërbime financiare ose mallra apo shërbim tjetër nga një filial si kusht për hyrjen në kontratë me bankën për të përftuar ndonjë shërbim tjetër financiar nga banka ose filiali.

26.3 Asnjë bankë nuk ofron rritje kredie ose dhënie kredie për të lehtësuar blerjen e letrave me vlerë të nënshkruara, të vendosura ose të shpërndara nga filiali i saj.

-
-

Neni 27

RESPEKTIMI I KËRKESAVE

Bankat duhet të respektojnë kufijtë e mëposhtëm maksimalë të përcaktuar nga BPK-ja:

- (a) Përqindjet dhe risqet maksimale që një bankë duhet të mbajë lidhur me aktivin, aktivin me risk, dhe zërat jashtë bilancit si dhe kategoritë e ndryshme të kapitalit dhe të rezervave;
- (b) Shumën agregate maksimale të kredive, të shprehura si përqindje e kapitalit të saj rregullator, që një bankë lejohet të japë ose të ketë kredi të papaguara nga ose në përfitim të një personi të vetëm ose grupi të personave të lidhur; dhe
- (c) Shumën agregate maksimale të kredive, të shprehura si përqindje e shumës agregate të gjithë kredive të saj, që një bankë lejohet të japë ose të ketë të papaguara nga ose në përfitim të dhjetë huamarrësve (duke përfshirë grupet e personave të lidhur) në lidhje me të cilët risku i bankës në llogarinë e transaksioneve të kredisë është më i madhi.

27.2 Bankat duhet të respektojnë kërkesat e mëposhtme të përcaktuara nga BPK-ja:

- (a) Kërkesat lidhur me shumën agregate minimale të aktivit likuid (menjëherë të kthyeshme në para) ose të kategorive specifike të këtij aktiviteti kundrejt vlerës ose ndryshimit në vlerë të aktivitetit (duke përfshirë garancitë dhe kolateralin e dhënë) të kategorive specifike të tyre ose kundrejt shumës a ndryshimit në shumë të pasivë, të kategorive specifike të pasivë me kusht që bankat të lejohen të plotësojnë nevojat e tyre për likuide duke mbajtur në bankë depozita me të njëjtën vlerë;
- (b) Kërkesat lidhur me shumën agregate maksimale të pasurive së patundshme dhe aktivës të qëndrueshme në posedim ose të kategorive specifike të tyre;
- (c) Kërkesat lidhur me klasifikimin dhe vlerësimin e aktivës dhe rezervave që duhen krijuar në bazë të këtyre klasifikimeve e vlerësimeve kundrejt huave të pakryera e huave nonstandard, huave të pashlyera, dhe koha kur fitimet nga huatë e pashlyera nuk mund të llogariten më si të ardhura përveç kur ato merrën në kesh dhe
- (d) Ndalimet, kufizimet ose kushtet në lidhje me llojet, me format e kredive dhe të investimeve të kryera, përputhjen e maturimit dhe të përqindjes së interesit për aktiva dhe pasiva (të paparashikuara ose të tjera) dhe pozicionet e hapura të këmbimit valutor, të metaleve dhe gurëve të çmuar, që tejkalojnë kufijtë e përcaktuar nga BPK-ja.

27.3 Asnjë bankë nuk bën shpërndarjen e kapitalit e as nuk paguan dividendë në qoftë se, sipas gjykimit të BPK-së, pas kryerjes së kësaj shpërndarjeje, kapitali rregullator minimal i kërkuar nga kjo rregullore ose me rregull apo urdhresë i bankës do të pakësohej nën shumën e kërkuar.

27.4 Asnjë bankë nuk mund të angazhohet drejtpërdrejt në veprimtari industriale, tregtare apo në veprimtari të tjera përveç veprimtarive financiare.

27.5 Asnjë bankë nuk jep kredi të siguar nga pjesëmarrja e saj në letra me vlerë.

27.6 Asnjë bankë nuk blen letra me vlerë të pjesëmarrjes së saj pa autorizimin paraprak të BPK-së.

Neni 28

DOKUMENTET E THEMELIMIT DHE REGJISTRIMET E TRANSAKSIONEVE

- 28.1 Çdo bankë përgatit dhe mban në drejtorinë e saj të përgjithshme dokumente me shkrim që përmbajnë:
- (a) Aktin e saj të themelimit ose dokumentet ekuivalente përkatëse, statutin dhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet lidhur me to;
 - (b) Regjistrin e aksionarëve të saj, duke përfshirë edhe numrin e aksioneve që janë regjistruar në emrin e secilit prej tyre;
 - (c) Procesverbalet e mbledhjeve dhe vendimet e Bordit drejtues;
 - (d) Procesverbalet e mbledhjeve dhe vendimet e mbledhjeve të aksionarëve dhe të mbledhjeve të Komitetit;
 - (e) Regjistrime të llogarive që nxjerrin qartë dhe saktë gjendjen e aktivitetit të saj, që shpjegojnë transaksionet e saj dhe pozicionin financiar në mënyrë që t'i japë mundësi BPK-së për të vendosur nëse institucioni ka vepruar në përputhje me gjithë dispozitat e kësaj rregulloreje dhe me rregullat dhe urdhresat në fuqi;
 - (f) Regjistrime për çdo klient të bankës, të përditshme, që tregojnë veçoritë e transaksioneve të tyre me ose për llogari të atij klienti dhe gjithë gjendjet në llogaritë e atij klienti; dhe
 - (g) Regjistrime të tjera që mund të kërkojë BPK-ja.

28.2 Çdo bankë krijon dhe mban në drejtorinë e saj të përgjithshme në Kosovë dokumentacion të rregullt të kredive dhe çdo informacion tjetër lidhur me marrëdhëniet dhe aktivitetet me klientët e saj dhe me personat e tjerë që BPK-ja mund t'i përcaktojë me rregullore.

Neni 29

NJOFTIMI I AFATEVE DHE I KUSHTEVE

Çdo bankë njofton rregullisht klientët e saj për politikat dhe procedurat më të reja lidhur me veprimtarinë e bankës dhe për afatet, kushtet dhe metodat e llogaritjes për depozitat e bëra dhe kreditë e marra prej tyre, duke përfshirë edhe llogaritjen e interesit të kombinuar vjetor dhe informacionin tjetër që mund ta përcaktojë BPK-ja.

Neni 30

TRANSAKSIONE ME PERSONA TË LIDHUR

30.1 Bankat dhe institucionet financiare nuk duhet të hyjnë në transaksione me ose në dobi të një personi që ka lidhje me to, nëse në një transaksion të tillë do të hyjej në kushte dhe afate më pak, ose fare të favorshme, me ose në dobi të personave që nuk janë të lidhur. Sipas këtij neni persona të lidhur konsiderohen personat pa asnjë kufizim të cilët administratori i bankës, aksioneri kryesor ose mbajtësi i interesit të konsiderueshëm në bankë; çdo person që është i lidhur me martesë, lidhje gjaku në shkallën e dytë ose interes ekonomik me administratorin, aksionerët kryesorë ose mbajtësit e interesit të konsiderueshëm; çdo person që ka një interes të konsiderueshëm tek një person juridik në të cilin banka ka një interes të konsiderueshëm. Pavarësisht nga ajo që u tha më sipër, asnjë bankë nuk jep kredi për ose në dobi të një personi të lidhur me bankën nëse si rezultat i kësaj shuma agregate e pjesës së papaguar të huave të të gjithë kredive të dhëna nga banka personave të lidhur me bankën do të ishte më e madhe kundrejt kapitalit rregullator të bankës ashtu

si përcaktohet nga BPK-ja.

30.2 Kredia e dhënë nga një banke, një banke ose institucioni financiar të lidhur është subjekt i kushteve dhe i kufizimeve shtesë, si përcaktohet me rregull. Sipas këtij paragrafi, një bankë ose institucion financiar i lidhur konsiderohet pa kufizim: çdo person ose institucion privat a shtetëror, disa persona ose institucione që veprojnë së bashku, çdo person që ka një interes të konsiderueshëm direkt ose indirekt me bankën që ia jep kredinë dhe çdo person juridik ose sipërmarrje në të cilën banka ka një interes të konsiderueshëm.

Neni 31

KREDIDHËNIE PËR PUNONJËSIT E BANKËS

Banka nuk jep ndihmë financiare për asnjë nga punonjësit e saj ose në dobi të tyre, përtej kufijve të përcaktuar nga BPK-ja.

LLOGARITË DHE DEKLARATAT, KONTROLLI FINANCIAR, RAPORTIMI DHE INSPEKTIMI

Neni 32

LLOGARITË DHE DEKLARATAT FINANCIARE

32.1 Bankat mbajnë llogari, regjistrime dhe përgatisin deklaratat vjetore financiare sipas rregullit për të pasqyruar operacionet dhe gjendjen financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe pasqyrojnë gjithashtu operacionet dhe gjendjen financiare të njësive të varura dhe degëve të bankës si në bazë individuale ashtu edhe të konsoliduar.

32.2 Llogaritë dhe deklaratat financiare duhet të jenë në formën e detajuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit ose sipas standardeve të tjera të kontabilitetit ashtu siç përcaktohet nga BPK-ja.

Neni 33

KONTROLLI FINANCIAR

33.1 Çdo bankë, me rekomandimin e Komitetit të kontrollit financiar, cakton një ekspert kontabël të jashtëm të kualifikuar dhe të pavarur, të miratuar nga BPK-ja, i cili duhet:

- (a) Të ndihmojë në mbajtjen e llogarive dhe regjistrimeve;
- (b) Të përgatitë një raport vjetor së bashku me opinionin e ekspertit kontabël nëse deklaratat financiare paraqesin një pamje të plotë dhe të ndershme të gjendjes financiare të bankës në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
- (c) Të shqyrtojë saktësinë e kontrollit financiar, të inspektimit të brendshëm e të procedurave dhe të bëjë rekomandime për përmirësimin e gjendjes dhe
- (d) Të informojë BPK-në për çdo veprim falsifikues të kryer nga një punonjës i bankës ose nga ndonjë njësi e saj të varur ose ndonjë parregullsi a mangësi në administrim, në operacionet që mund të pritet të rezultojnë me një humbje materiale për bankën apo njësitë e varura.

33.2 Për banka, aktiva e të cilave nuk e tejkalojnë shumën e përcaktuar nga BPK-ja, funksionet e përshkruara në paragrafin 33.1 mund të kryhen nga kontrollori i brendshëm financiar me kusht që ky kontrollor financiar të ketë jo më pak se dhjetë vjet përvojë profesionale në kontrollin financiar.

33.3 Një bankë, aktiva ose aktivitetet e së cilës përbëjnë shqetësim për BPK-në duhet të punësojë, me këshillën dhe pëlqimin e Komitetit të saj të kontrollit financiar, një kontrollor të brendshëm financiar të aftë dhe të përshtatshëm.

33.4 Kontrollori financiar i brendshëm i raporton komitetit të kontrollit financiar i cili përcakton kompensimin e tij/saj.

33.5 Kontrollorit financiar të brendshëm i jepet mundësi të njihet me menaxhimin dhe anëtarët e menaxhimit për të diskutuar çështjet përkatëse të funksioneve të tyre dhe me kërkesë ka të drejtë të përftojë prej tyre informacion ose dokumente të cilat ai/ajo i kërkon.

33.6 Kontrollori financiar i brendshëm nuk ka kompetencë të hyjë ose të përfaqësojë ndonjë bankë në kontrata ose transaksione të tjera.

33.7 Kontrollori financiar i brendshëm vepron i pavarur nga menaxhimi dhe ka një detyrë speciale besnikërie të kujdesit dhe ndershmërisë ndaj bankës.

33.8 Kontrollori financiar i brendshëm duhet:

- (a) Të krijojë sistemet e kontrollit të brendshëm, të kënaqshme për Komitetin e kontrollit financiar për të bërë kontrollin financiar dhe të kritikojë politikat dhe procedurat në lidhje me kontabilitetin, administrimin, operacionet dhe ruajtjen e aktives;
- (b) Të krijojë dhe zbatojë programe të brendshme, të kënaqshme për Komitetin e kontrollit financiar, për të kryer teste pa paralajmërim për mospërputhje dhe parregullsi në departamentet e zgjedhura në bazë të vlerësimit të problemeve në këto departamente nga kontrollori i brendshëm;
- (c) Të raportojë veprimet që nuk janë në përputhje me rregullat dhe parregullsitë në Komitetin e Kontrollit Financiar në intervale kohe dhe procedura që Komiteti i Kontrollit Financiar mund të caktojë dhe, kur e kërkojnë rrethanat, të raportojë edhe në BPK;
- (d) Të ndihmojë, bashkëpunojë dhe kontrollojë ekspertin kontabël të jashtëm në kryerjen e detyrave të tij/saj dhe
- (d) Të kryejë edhe detyra të tjera që mund të përcaktohen në rregulloret ose urdhresat e bankës.

Neni 34

BOTIMI I BILANCIT, OPINIONIT TË EKSPERTIT KONTABËL, RAPORTIT VJETOR

34.1 Çdo bankë brenda tridhjetë ditëve të çdo tremujori kalendarik duhet të botojë në një gazetë kombëtare një përmbledhje të vërtetë dhe të ndershme të bilancit të saj të tremujorit kalendarik të mëparshëm. Çdo bankë duhet gjithashtu, brenda katër muajve nga mbyllja e vitit të saj financiar, të botojë në një gazetë kombëtare një përmbledhje të vërtetë dhe të ndershme të bilancit të saj dhe opinionin e ekspertit të saj kontabël për vitin fiskal të mëparshëm.

34.2 Çdo bankë duhet gjithashtu të botojë raportin e saj vjetor dhe t'ia vë në dispozicion të publikut kopjet e tyre sipas kërkesave dhe pa pagesë.

-

Neni 35

DEGET E BANKAVE TE HUAJA

Degët e bankave të huaja duhet të botojnë bilancin e tyre dhe deklaratat e të ardhurave në bazë të konsoliduar dhe t'ia dorëzojnë ato BPK-së çdo tremujor ose në intervale të tjera kohe kur kërkohen nga BPK-ja. Të gjitha këto raportime financiare bëhen në përputhje me standardet e kontabilitetit ndërkombëtare.

Neni 36

RAPORTET DHE SHQYRTIMET FINANCIARE

36.1 Çdo bankë përgatit dhe dorëzon në BPK raporte lidhur me administrimin dhe operacionet, likuiditetin, aftësinë paguese dhe fitimin, si për vete edhe për degët, në bazë individuale dhe të konsoliduar. Raportet përgatiten sipas përcaktimeve të BPK-së për formën dhe detajimin si dhe intervalet kohore të dorëzimit.

36.2 Çdo bankë dhe çdo degë e saj është subjekt i shqyrtimeve financiare nga inspektorët e BPK-së ose nga ekspertë kontabël të caktuar nga BPK-ja. Këta ekspertë kontabël mund të jenë zyrtarë të autoritetit të një vendi tjetër të huaj të ngarkuar me mbikëqyrjen monetare ose të respektimit të rregullave të aktiviteteve financiare në atë vend nëse shqyrtimi financiar bëhet për një bankë që është degë ose njësi e varur e një banke të huaj që ka drejtorinë e saj qendrore në atë vend ose ka një interes të konsiderueshëm në një bankë të huaj që është e vendosur në atë vend.

36.3 Në shqyrtimet e bankave dhe njësive të tyre të varura, BPK-ja dhe ekspertët kontabël të caktuar prej saj mund:

- (a) Të shqyrtojnë llogaritë, librat, dokumentacionin dhe regjistrimet e tjera të bankës a të njësisë së varur dhe
- (b) Të kërkojnë nga administratorët, punonjësit dhe agjentët e bankës a të njësisë së varur për të vënë në dispozicion të tyre gjithë këtë informacion ose çeshtje të tjera lidhur me administrimin dhe operacionet e saj që ata mund të kërkojnë brenda arsyes.

36.4 Çdo bankë dhe çdo njësi e varur e saj duhet të pranojë dhe bashkëpunojë plotësisht me inspektorët e BPK-së dhe ekspertët kontabël të caktuar nga BPK-ja. Askush nuk ka të drejtë të përpiqet të provokojë, pengojë, vonojë, ndalojë, frikësojë ose të ushtrojë influencë të pajustificuar ndaj një inspektori të BPK-së ose ekspertëve kontabël të caktuar prej saj.

36.5 Çdo filial i një banke dhe ofruesit e shërbimeve operationale ose profesionale për bankat i japin informacion PBK-së që BPK-ja me arsye mund të kërkojë lidhur me operacionet dhe marrëdhëniet e bankës me këta persona.

KUNDËRVAJTJET, DENIMET DHE MASAT PËRMIRËSUESE

Neni 37

KUNDËRVAJTJET, DENIMET DHE MASAT PËRMIRËSUESE

37.1 BPK-ja përcakton masat përmirësuese dhe dënimet e dhëna për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen.

37.2 BPK-ja mund të ndërmarrë veprimet e mëposhtme ose të vendosë dënimet e mëposhtme ndaj një banke a institucioni financiar nëse konstaton se banka, institucioni financiar, ose një nga administratorët aksionarët kryesorë dhe ata që kanë interes të konsiderueshëm në të ka shkelur një dispozitë të kësaj rregulloreje ose të ndonjë rregulli a urdhërese të BPK-së, ka shkelur çfarëdo kushti apo kufizimi të bashkëngjitur në një autorizim të lëshuar nga BPK-ja ose është angazhuar në praktika të pasigurta dhe jo të shëndosha prandaj sipas gjykimit të BPK:

- (a) Jep vërejtje me shkrim;
- (b) Lidh marrëveshje me shkrim me Bordin drejtues për përdorimin e një programi për ndërmarrjen e masave përmirësuese;
- (c) Nxjerr urdhresa me shkrim për pushimin dhe heqjen dorë nga këto kundërvajtje dhe për marrjen e masave përmirësuese;
- (d) Vendos gjopa për bankën ose institucionin financiar ose për administratorët, aksionerët kryesorë të saj dhe për ata që mbajnë një interes të konsiderueshëm në to në shuma nga 500 DM deri në 5 000 DM për çdo ditë që vazhdon kundërvajtja me kusht që për të njëjtat kundërvajtje gjopat të jenë në shuma të ngjashme për banka dhe institucione financiare me total të krahasueshëm aktivash.
- (e) Pezullon përkohësisht ose shkarkon ushëheqjen, anëtarin ose anëtarët, Bordin drejtues, anëtarin ose anëtarët e tij dhe
- (f) Anulon licencën e bankës ose të institucionit financiar dhe emëron një kujdestar.

37.3 Për bankat, kapitali rregullator i të cilave është përcaktuar nga BPK-ja të jetë më i vogël se dy të tretat e kapitalit rregullator minimal të kërkuar, përveç masave të përcaktuara në paragrafin 37.2, BPK-ja mund të ndërmarrë një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- (a) Të kërkojë që totali mesatar i aktivës të bankës gjatë një tremujori të mos tejkalojë totalin mesatar të aktivës të saj të tremujorit të mëparshëm;
- (b) Të kërkojë nga banka që të mos përfitojë pjesëmarrje aksionere nga ndonjë person juridik, ose sipërmarrje, të krijojë ose shtojë degë të reja, ose të angazhohet në veprimtari të tjera të reja;
- (c) Të kërkojë që banka të mos japë kredi për ndonjë filial, përveç kur kjo kredi është e mbuluar me kolateral nga letra me vlerë të tregtueshme të emetuara ose garantuara nga një qeveri e një vendi të Bashkimit Europian, mbajtur nën kujdesin e një agjenti dorëzanës, vlera e tregut e të cilave në çdo kohë tejkalon 125% të shumës së kredisë; dhe
- (d) Të kërkojë që përqindja e interesit që banka paguan mbi depozitat të mos tejkalojë përqindjen mbizotëruese të interesit mbi depozitat në shuma dhe maturim të krahasueshëm në rajonin ku banka është vendosur, si përcaktohet nga BPK-ja.

37.4 Për bankat, kapitali rregullator i të cilave është përcaktuar nga BPK të jetë më i vogël se gjysma e kapitalit rregullator minimal të kërkuar, përveç masave që mund të merren në përputhje me paragrafët 37.2 dhe 37.3, BPK-ja mund të ndërmarrë një ose më shumë nga masat ose të vendosë dënimet e mëposhtme:

- (a) Të kërkojë që banka ose një nga njësitë e varura të saj të ndryshojë, zvogëlojë ose përfundojë ndonjë nga aktivitetet që BPK-ja përcakton se ka shkaktuar humbje materiale për bankën;
- (b) Të kërkojë që banka të shkarkojë një ose më tepër administratorë që kanë ushtruar detyrën për më shumë se 180 ditë menjëherë para se kapitali i kërkuar i bankës të jetë zvogëluar nën shumën e kërkuar, si është përcaktuar nga BPK-ja;
- (c) Të kërkojë që banka të heqë dorë vetë ose të likuidojë njësitë e varura, nëse BPK-ja përcakton se njësia e varur rrezikon të vihet në kushtet e paaftësisë paguese ose ka shkaktuar humbje materiale për bankën dhe
- (d) Të kërkojë që asnjë administrator të mos marrë asnjë shpërblim ose të marrë pagë në shumën që tejkalon shumën mesatare të pagës së personit (me përjashtim të shpërblimeve, të drejtës për blerje aksionesh me çmim fiks më të ulët dhe ndarjes së fitimit) gjatë dymbëdhjetë muajve kalendarikë para muajit në të cilin, sipas mendimit të BPK-së, banka ka mbetur pa kapital rregullator të mjaftueshëm.

37.5 Për bankat, kapitali rregullator i të cilave është përcaktuar nga BPK-së që të jetë më i vogël se një e katërta e kapitalit rregullator minimal të kërkuar, përveç masave që mund të merren në përputhje me paragrafët 37.2, 37.3 dhe 37.4, BPK-ja cakton një kujdestar për bankën.

37.6 Masat dhe dënimet e parashikuara në këtë nen nuk përjashtojnë zbatimin e dënimeve të tjera, civile ose penale, si parashikohet në legjislacionin në fuqi.

37.7 Çdo gjobë ose shumë e vendosur në përputhje me këtë nen depozitohet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

37.8 Dënimet e përcaktuara në paragrafin 37, 2 mund të zbatohen ndaj gjithë personave që shkelin dispozitat e nenit 3 dhe BPK-ja gjithashtu, pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e ligjit, ka kompetencë të kërkojë likuidimin e aktivitetit ekonomik të këtij personi sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 38

PEZULLIMI DHE SHKARKIMI I PERSONAVE TË NJË BANKE

38.1 Nëse BPK-ja përcakton që një administrator, punonjës ose mbajtës i një interesi të konsiderueshëm në një bankë, me qëllim ose vazhdimisht ka kryer shkelje të kësaj rregulloreje ose të një rregulli ose urdhërese që ka shkaktuar humbje materiale për bankën, ose të ardhura financiare për atë person, ose është angazhuar në praktika të pasigurta dhe të parregullta dhe ka vazhduar të kryejë këto shkelje ose praktika edhe pas tërheqjes së vërejtjes me shkrim nga BPK-ja, atëherë BPK-ja mund të nxjerrë një urdhëresë që përmban një ose të gjitha dispozitat e mëposhtme:

- (a) Të kërkojë shkarkimin e personit nga detyra që ka në bankë;
- (b) Të ndalojë këtë person të punojë ose të angazhohet në veprimtari bankare ose financiare për një periudhë të caktuar ose përgjithmonë;
- (c) Të ndalojë personin nga ushtrimi direkt ose indirekt i të drejtës së votimit që i bashkëngjitet aksioneve të bankës.
- (d) T'i kërkojë personit që të japë plotësisht ose pjesërisht pjesën e tij të pronësisë direkte ose indirekte që ka në bankë ose të pushojë mbajtjen e një interesi të konsiderueshëm në bankë; dhe

(e) T'i kërkojë personit të paguajë bankën për humbjet e shkaktuara nga këto kundërvajtje.

38.2 Nëse një person i tillë akuzohet për një vepër penale, BPK-ja mund të nxjerrë një urdhresë për pezullimin e përkohshëm të këtij personi nga detyra e tij në bankë dhe, nëse është e zbatueshme, për pezullimin e ushtrimit të të drejtës së votimit në bazë të aksioneve të personit në bankë, deri në përfundim të çështjes penale. Pushimi i çështjes penale ose vendimi i pafajësisë në këtë rast nuk e pengon BPK-në që të ndër marrë ndaj personit masa ndëshkimore të autorizuara nga kjo rregullore.

38.3 Asnjë person nuk mund të mbajë një pozitë dhe as të marrë pjesë në çfarëdo mënyre në kryerjen e veprimtarive në një filial të një bankë që angazhohet në shërbime financiare pa miratimin paraprak me shkrim të BPK-së, nëse ky person është subjekt i një urdhërese të BPK-së për pezullimin ose shkarkimin e tij nga një detyrë në bankë, për ndalimin e ushtrimit të të drejtës së votimit në bazë të aksioneve që ka në bankë ose që i kërkon atij të japë interesin e pronësisë që ka në bankë.

38.4 Në rast se një person brenda afatit të caktuar, nuk i shet ose nuk jep aksionet me të drejtë vote të një banke në përputhje me urdhëresën e nxjerrë sipas këtij neni, BPK-ja mund të urdhërojë që të gjitha aksionet e mbajtura nga ky person në bankë të transferohen në një dorëzani (truste) për shitje në ankand dhe të ardhurat neto, pas zbritjes së shpenzimeve të shitjes, i jepen atij personi.

FALIMENTIMI

Neni 39

KRITERET PËR FILLIMIN E FALIMENTIMIT PËR SHKAK TË PAAFTËSISË PAGUESE

39.1 Nëse BPK-ja konstaton se një bankë është josolvente ose i është revokuar licenca e saj, apo me arsye pritet të bëhet josolvente brenda nëntëdhjetë ditëve të ardhshme, BPK-ja revokon licencën e asaj banke dhe menjëherë e vë bankën nën posedimin dhe kontrollin e saj nëpërmjet një drejtori të përkohshëm (më tej "drejtori") të cilin e emëron BPK-ja. Kjo procedurë do të quhet Falimentim.

39.2 Sipas kësaj rregulloreje:

- (a) Një bankë konsiderohet josolvente në qoftë se nuk paguan plotësisht dhe në afat detyrimet e saj ose kur vlera e pasivës e tejkalon vlerën e aktivës;
- (b) Vlera e aktives, pasives dhe e kapitalit rregullator të një banke përcaktohet në përputhje me standardet e vlerësimit dhe procedurat e përcaktuara nga BPK-ja dhe
- (c) Në përcaktimin e vlerës së aktivës dhe pasivës të një banke për një datë të ardhshme, merren parasysh të ardhurat dhe shpenzimet e ardhshme të parashikuara mbi baza të arsyeshme të bankës deri në atë datë.

39.3 Drejtori mund të jetë një person nga sektori privat ose një zyrtar i BPK-së që plotëson kualifikimet e përcaktuara nga BPK-ja. BPK-ja mund ta shkarkojë drejtorin për arsye të forta. Kushtet për shpërblimin e drejtorit mund të përfshijnë stimulimet për përmbushja e objektivave të përcaktuara në paragrafin 41.1 dhe mund të përfshijnë edhe dënimet për mospërmbushjen e këtyre objektivave.

39.4 Shpërblimi i drejtorit dhe i ekspertëve që ai/ajo angazhon, kompenzimi i shpenzimeve të tyre dhe i shpenzimeve të BPK-së për zbatimin e kësaj rregulloreje lidhur me një bankë duhet të paguhet nga aktiva e bankës. Paga e drejtorit bëhet rregullisht, nëse sipas mendimit të drejtorit ka aktive likuide të mjaftueshme, me kusht që drejtori dhe agjentët e drejtorit të mos paguhet për tarifën dhe shpenzimet e tyre në një muaj

kalendari më shumë se paguhet interesi për depozituesit e përcaktuar në paragrafin 43.1(b). Shuma që drejtori nuk e ka marrë deri në fund të falimentimit paguhet nga të ardhurat prej shitjes së aktivës së bankës me përparësitë e përcaktuara në nenin 43.

Neni 40

NJOFTIMI DHE REGJISTRIMI I FALIMENTIMIT

40.1 Drejtori dy ditë pas emërimit të tij/saj vendos në çdo zyrë të bankës një njoftim për shpalljen e këtij veprimi në përputhje me këtë rregullore, ku specifikohet data e hyrjen në fuqi dhe perioda e vënies nën falimentim nga drejtori, duke specifikuar që:

- (a) Autorizimet e dhëna personave për përgjegjësinë financiare të bankës janë shfuqizuar;
- (b) Personat, të cilët më parë kishin autorizim për dhënien e udhëzimeve në emër të bankës në lidhje me pagesat ose transferimin e aktivës të bankës a të aktiveve të menaxhuar nga banka, janë xhveshur nga këto kompetenca dhe
- (c) Licenca e bankës është revokuar.

40.2 Drejtori boton një njoftim për specifikimin e masave të ndërmarra në një ose më shumë gazeta me qarkullim të përgjithshëm në komunitetet ku banka ka zyra dhe vazhdon botimin e këtij njoftimi çdo javë për katër javë rresht, si dhe informon sipas nevojës autoritetet kompetente dhe i dërgon BPK-së kopje të këtyre masave brenda dy ditësh nga ndërmarrja e tyre.

Neni 41

KOMPETENCAT DHE DETYRAT E DREJTORIT DHE EFEKTET E VËNIES NËN FALIMENTIM

41.1 Drejtori ka gjithë kompetencat e administratorëve dhe aksionerëve të bankës në fjalë dhe, pavarësisht se licenca e bankës është revokuar, sipas paragrafit 41.2, mund të vërë në funksionim bankën nën emrin e saj dhe të marrë të gjitha masat për shitjen e bankës dhe të aktivës të saj që, sipas mendimit të drejtorit, mund të rezultojë në pagimin e një pjese më të madhe të detyrimeve të bankës ndaj depozituesve dhe kreditorëve të tjerë brenda një viti nga data e emërimit në krahasim me ndonjë masë tjetër alternative; BPK-ja mund të zgjasë falimentimin për një periudhë të mëtejshme deri në gjashtë muaj në qoftë se, sipas mendimit të saj, kjo shtesë kohe do të rezultonte në një rritje të ndjeshme të përmbushjes së detyrimeve të bankës. Për arritjen e objektivit kryesor të përmbushjes maksimale të detyrimeve të bankës ndaj kreditorëve, drejtori përshpejton shitjen e bankës ose të aktivës të saj dhe pagesat për kreditorët.

41.2 Drejtori mund të vazhdojë çfarëdo operacionesh, përveç pranimin të depozitave të reja dhe dhënies së kredive klientëve ekzistues për pjesën e huave që nuk u është papaguar atyre akoma dhe mund të marrë para hua si të siguruara ashtu edhe të pasiguruara. Drejtori mund të ndërpresë ose të kufizojë pagesën për çdo detyrim, të punësojë ose të pushojë nga puna cilindo zyrtar, punonjës ose këshilltar, të përdorë çdo instrument në emër të bankës dhe të fillojë ose të mbrojë dhe të kryejë në emër të bankës çdo veprim a procedurë ligjore.

41.3 Drejtori ka mundësi të pakufizuara për kontrollin e zyrave, librave të llogarive, dhe të regjistrimeve të tjera si dhe të aktivës të tjera të bankës dhe njërive të saj të varura. Me kërkesën e drejtorit, një oficer ose oficerë të organeve të zbatimit të ligjit duhet të ndihmojnë drejtorin për të hyrë në lokalet e bankës për të bërë kontrollin e të dhënave të bankës.

41.4 Çdo person i cili qëllimisht ndërhyr në hyrjen e drejtorit në mjediset e bankës ose në kontrollin e

zyrave, librave të llogarive dhe regjistrimeve të tjera, si dhe të aktivës të tjera të një banke për të cilën ai/ajo është emëruar, dënohet me burgim për një periudhë prej një viti deri në pesë vjet ose me gjobë prej 1000 DM deri në 5000 DM në ditë për çdo ditë që vazhdon kundërvajtja ose të dyja bashkë.

41.5 BPK-ja miraton ose refuzon bashkimin e bankës me një bankë tjetër ose shitjen substanciale të të gjithë aktivës së bankës një banke tjetër, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenin 15.

41.6 Drejtori ka të njëjtat të drejta dhe privilegje si dhe i nënshtrohet detyrave, dënimeve, kushteve dhe kufizimeve të njëjta të zbatueshme për administratorët ose punonjësit e tjerë të një banke të licencuar sipas kësaj rregulloreje.

41.7 Kompetencat e administratorëve dhe aksionerëve të bankës pezullohen gjatë periudhës së falimentimit, me kusht që administratorët të mund të udhëzohen nga drejtori për të kryer funksionet e specifikuar për bankën; si edhe me kusht që këta persona të shkarkohen nga drejtori prej detyrave të tyre në bankë dhe për pasojë të mos marrin më rrogë nga banka.

41.8 Drejtori siguron aktiven e bankës për të parandaluar humbjen e tyre nëpërmjet vjedhjes ose veprimeve të tjera të ndaluara, duke ndërmarrë masat e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to, siç janë:

- (a) Ndërrimin e bravave dhe kufizimi i mundësisë së marrjes së çelësave të rinj për dyert e jashtme dhe dyert e brendshme të mjediseve ku ndodhen aktiven financiare, informacioni ose pajisjet që lejojnë një person të ketë mundësi të futet në mënyrë të paligjshme në aktiven financiare;
- (b) Ndërrimi ose vendosje e kodeve hyrëse në kompjuterët e bankës dhe dhënien e mundësisë së hyrjes për vetëm një numr të kufizuar të punonjësve të besuar;
- (c) Nxjerrja e lejeve të reja fotoidentifikuese për hyrjen e punonjësve të autorizuar në lokalet e bankës dhe kontrollimi i hyrjes së personave të tjerë në mjediset e bankës;
- (d) Shfuqizimi i autorizimeve të personave për mbajtjen e përgjegjësive financiare të bankës dhe dhënia e autorizimeve të reja, sipas rregullit, dhe njoftimin e palëve të treta për këtë;
- (e) Informimi i bankave korrespondente, regjistruarit dhe agjentët e transferimit të letrave me vlerë, dhe menaxherët e jashtëm të aktivës së bankës që personat, të cilët më parë ishin të autorizuar për dhënien e udhëzimeve në emër të bankës në lidhje me aktiva e bankës, ose aktiva e mbajtur që ruhet nga banka nuk janë më të autorizuar dhe që vetëm drejtori dhe personat e autorizuar nga drejtori i kanë këto kompetenca dhe
- (f) Pezullimi i pagesave të shpërndarjes së kapitalit në përgjithësi dhe pagesat e çdo lloji për administratorët dhe aksionarët kryesorë, me kusht që administratorëve të mund t'u paguhet rroga bazë për shërbimet e kryera në cilësinë e tyre si administratorë të bankës.

41.9 Drejtori krijon një bilanc të ri për bankën, në bazë të përcaktimit të tij/saj të vlerave likuiduese të aktiveës së bankës me një pakësim korrespondues me vlerën e detyrimeve të bankës, me rend të kundërt të përparësisë në pagesën e shpërndarjeve në një likuidim të një aktivi të bankës. Detyrimet konsiderohen të maturuara dhe të pagueshme dhe interesi ndërpritet së akumuluari në datën e emërimit të drejtorit. Detyrimet e pamaturuara skontohen nga vlera aktuale në masën e interesit të përcaktuar nga BPK-ja.

41.10 Brenda një muaji nga marrja në posedim të bankës, drejtori bën inventarin e aktivës dhe të pronës së bankës dhe një kopje të inventarit ia dërgon BPK-së, e cila e vë një kopje në dispozicion për shqyrtim nga publiku.

41.11 Pesëmbëdhjetë ditë pas emërimit, drejtori mund të vërë në dispozicion për tërheqje nga depozituesit ose për pagesë të kreditorëve shuma të tilla që, sipas mendimit të tij/saj, mund të përdoren brenda rregullit për këtë qëllim me kusht që të gjithë depozituesit ose kreditorët e tjerë të cilët ndodhen në pozita të njëjta të trajtohen në të njëjtën mënyrë; si edhe me kusht që para një shpërndarjeje të përgjithshme të pagesave kreditorëve të bankës ose marrjes përsipër të detyrimeve të bankës nga një bankë tjetër, kreditorët përveç atyre të përcaktuar në paragrafin 43.1 (b) të mos marrin më tepër se 50% të shumës së pretendimeve të tyre të lejuara, ashtu si përcaktohet nga drejtori.

41.12 Kur drejtori i përkohe e marr bankën në posedim:

- (a) Çdo afat statutor, kontraktues ose tjetër, me skadimin e të cilit skadon ose shuhet një pretendim ose e drejtë e bankës zgjatet edhe gjashtë muaj nga data e skadimit ose e shuarjes;
- (b) Çdo pretendim ose pjesëmarrje akcionare (përveç atij që ekziston gjashtë muaj para hyrjes në fuqi të vënies nën drejtori) anulohet dhe asnjë pretendim ose pjesëmarrje akcionare, përveç atij të krijuar nga drejtori në zbatim të këtij neni, nuk i bashkohet ndonjë aktivi ose pasurie të bankës për aq kohë sa zgjat falimentimi;
- (c) Të drejtat e aksionarëve shuhen, përveç së drejtës së marrjes së fitimeve, nëse ekzistojnë, sipas paragrafit 43.3 dhe së drejtës për marrjen e një pagese neto të përfutur nga shitja e bankës ose e shumicës së aktivës të saj në qoftë se drejtori vendos që banka kishte vlerë neto pozitive në kohën e shitjes dhe
- (d) Drejtori mund të emetojë aksione të reja në bankë, të shesë aktivën e bankës ose të bjerë dakort për marrjen hua të parave në kushte që ai i konsideron të drejta.

41.13 Procedurat për përcaktimet e vlefshmërisë dhe përparësive të pretendimeve dhe për likuidimin e aktivës së bankës dhe kthimin e pasurisë klientëve të bankës përcaktohen nga BPK-ja, me kusht që shitja e aktivës së bankës të kryhet në mënyrë transparente dhe të arsyeshme në pikëpamje tregtare.

41.14 Aktiva e pashitur e bankës deri në fund të afatit të falimentimi mund të lihen nga drejtori ose t'i jepen ndonjë institucioni bëmirës që nxit qështjen e ruajtjes së shëndetit dhe të arësimit publik. Kreditorët e bankës nuk mund të kenë pretendime ndaj kësaj aktive.

41.15 Drejtori raporton çdo muaj në BPK për ecurinë e falimentimit në formën e përcaktuar nga BPK-ja.

Neni 42

SHMANGIA E TRANSFERIMEVE TË NDODHURA PARA FALIMENTIMIT

42.1 Drejtori mund të fillojë procedurë gjyqësore për të anuluar një transaksion të bazuar në dokumente mashtruese dhe të falsifikuara që banka ka ekzekutuar në dëm të kreditorëve që ka ndodhur brenda pesë vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të vënies nën drejtori.

42.2 Drejtori mund të fillojë procedurë gjyqësore për të anuluar transaksionet e mëposhtme, që ndikojnë në aktiva e bankës ose të marrë prej të tretëve transferimet e bëra nga banka, siç janë:

- (a) Transferimet e bëra në dobi të administratorëve, akcionerëve kryesorë ose mbajtësve të interesave të konsiderueshëm në bankë ose personave të lidhur me ta, që kanë ndodhur brenda

pesë vjetëve para datës së hyrjes në fuqi të falimentimit;

- (b) Transfertat e bëra në dobi të palëve të treta që kanë ndodhur brenda tri vjetëve para hyrjes në fuqi të falimentimit;
- (c) Transaksionet në të cilat vlera e dhënë nga banka tejkalon në mënyrë të konsiderueshme vlerën e marrë, që kanë ndodhur brenda tri vjetëve para datës së hyrjes në fuqi të falimentimit;
- (d) Çdo veprim i bërë me qëllim nga gjithë palët e përfshira në të për të mbajtur aktivë nga kreditorët e bankës ose për të minimizuar të drejtat e tyre, që kanë ndodhur brenda pesë vjetëve para datës së hyrjes në fuqi të falimentimit; dhe
- (e) Transferimet e pronës së bankës te një kreditor ose në dobi të një kreditori për llogari të një borxhi që ka ndodhur brenda gjashtë muajve para datës së hyrjes në fuqi të falimentimit që ka efektin e rritjes së shumës që kreditori do të merrte me likuidimin e bankës, me kusht që pagesa e depozitave në një shumë që nuk tejkalon 1000 DM për depozitorë të mos jetë subjekt i kësaj dispozite.

42.3 Transaksionet me personat e lidhur me bankën të kryera brenda një viti para datës së hyrjes në fuqi të falimentimit, në qoftë se dëmtimi i interesave të depozituesve dhe kreditorëve të tjerë mund të evitohet dhe të mbulohet dëmi nga këta persona.

42.4 Një veprim për anulimin e një transferte mund të ndërmerret nga drejtori brenda një viti nga hyrja në fuqi e procedurës së falimentimit.

42.5 Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 42.1 deri 42.4, drejtori mund të mos anulojë një pagesë ose transfertë nga banka, në qoftë se është kryer në rrjedhën e zakonshme të aktivitetit të bankës, ose nëqoftëse ka qenë pjesë e një këmbimi të njëkohshëm për vlerë të barabartë në mënyrë të arsyeshme a në masën që në vijim të transfertës marrësi i ka dhënë bankës kredi të re të pasiguar që nuk është paguar nga banka deri në datën e hyrjes në fuqi të falimentimit.

42.6 Drejtori mund të marrë pasurinë ose vlerën e pasurisë së transferuar nga banka te një person i parë i cili ia transferon pasurinë një personi të dytë, vetëm në qoftë se personi i dytë nuk ka dhënë vlerën reale për pasurinë dhe e ka ditur se transferimi fillestar mund të anulohet sipas kësaj rregulloreje.

42.7 Drejtori mund të urdhërojë që njoftimi i gjykatës për një çështje të anulimit të një transferte të regjistrohet në regjistrin publik për pronësinë mbi pasurinë e patundshme dhe çdo të drejte mbi pasurinë dhe një person që merr titullin ose blen ndonjë pjesëmarrje aksionere a interes tjetër mbi këtë pasuri, pas arkivimit të një njoftimi të tillë, titulli ose pjesëmarrja e marrë prej tij është subjekt i të drejtave të bankës për ta marrë atë pasuri.

42.8 Pronari i mjediseve të bankës ose ndërmarrja komunale apo ndonjë furnizues tjetër i shërbimeve komunale, duke përfshirë pa kufizim një ndërmarrje që furnizon energji elektrike, gaz natyror, ujë ose shërbime të telefonisë, mund të mos ndryshojë, refuzojë ose ndërpresë këto shërbime për një bankë për shkak të vënies së saj nën falimentim ose për shkak se debitori nuk ka paguar para për shërbimet e falimentimit të saj; me kusht që me kërkesën e pronarit të mjediseve të bankës ose ndërmarrjes komunale, banka duhet të vendosë një depozitë sigurimi në një bankë tregtare, si kusht për pronarin e lokalit të bankës ose ndërmarrjen komunale që të vazhdojnë kryerjen e shërbimeve edhe gjatë falimentimit, dhe kjo depozitë nuk kërkohet të jetë më e madhe se kostoja e shërbimeve të kryera për bankën gjatë muajit menjëherë para ardhjes në fuqi të falimentimit.

Neni 43

PËRPARËSITË NË PAGESAT E PRETENDIMEVE

43.1 Në çdo likuidim të aktivës të një banke, pretendimet e siguruara të ligjshme duhet të paguhen në masën e kolateralit të vënë për sigurim të borxhit ose kolaterali i kthehet kreditorit të siguruar. Pretendime të tjera të ligjshme paguhen në raport me të gjitha borxhet e tjera sipas radhës së përcaktuar më poshtë:

- (a) Shpenzime të nevojshme dhe të arsyeshme të bëra nga drejtori dhe BPK-ja, duke përfshirë edhe honoraret profesionale për zbatimin e dispozitave të neneve për falimentimit në këtë rregullore;
- (b) Depozitat e çdo depozituesi që nuk tejkalojnë shumën që është 10 herë më e madhe se paga mesatare mujore mbizotëruese;
- (c) Shuma e papaguar në depozita dhe
- (d) Pretendime të tjera të kreditorëve ndaj bankës.

43.2 Nëse shuma e vënë në dispozicion për pagesa për çdo klasë të pretendimeve nuk është e mjaftueshme për të bërë pagesën në tërësi, pretendimet zvogëlohen në proporcione të njëjta.

43.3 Pas pagesës së të gjitha pretendimeve të paraqitura bëhet pagesa e atyre pretendimeve të ligjshme që nuk ishin paraqitur brenda afatit të përcaktuar me rregull për dorëzimin e tyre. Pasi paguhen të gjitha pretendimet e depozituesve dhe kreditorëve të tjerë, të ardhurat që mbeten u shpërndahen aksionarëve të bankës sipas të drejtave të tyre.

Neni 44

RAPORTIMI PËRFUNDIMTAR NE BPK

Pasi bëhet shpërndarja e të ardhurave nga shitja e aktivës të bankës, drejtori i paraqet një raport BPK-së, që përfshin një deklaratë të të ardhurave dhe shpenzimeve, burimet dhe përdorimet e fondeve gjatë periudhës së falimentimit. Me miratimin nga BPK-ja të këtij raporti, BPK-ja dhe drejtori shkarkohen nga çdo përgjegjësi e mëtejshme në lidhje me falimentimin e një banke.

Neni 45

DISPOZITA TË NDRYSHME TË FALIMENTIMIT

45.1 Punonjësit profesionistë, të caktuar për të përfaqësuar ose ndihmuar një kujdestar ose BPK-në në lidhje me një kujdestar nuk paguhen në shuma më të mëdha se paguhen punonjësit ose agjentët e bankave për shërbime të njëjta, përveç kur BPK mund të autorizojë pagesa në shuma më të larta, nëse BPK-ja vendos se është e nevojshme të paguhet shuma më të larta në mënyrë që të punësohet dhe mbahet personeli i nevojshëm.

45.2 BPK-ja ka kompetencë të shpërblejë një kujdestar dhe agjentët e tij për punën e tyre që kanë kryer sipas kushteve që BPK-ja i konsideron të përshtatshme.

45.3 Të gjitha pretendimet e ngritura lidhur me paaftësinë paguese të një banke apo të një banke në falimentim kundër drejtorit të përkohshëm a BPK-së në raport me një bankë të licencuar sipas kësaj rregulloreje do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e saj. Asnjë ankesë nuk mund të bëhet për veprimet e një drejtori ose të BPK-së, përveç aksionerëve të një banke që mbajnë jo më pak se dhjetë për qind të

aksioneve të çdo klase me të drejtë vote.

45.4 Çdo procedurë gjyqësore ose administrative e ngritur kundër një banke ose në lidhje me paaftësinë paguese të saj apo kundër administratorit të ndonjë banke, drejtorit a BPK-së në lidhje me një bankë të licencuar sipas kësaj rregulloreje, dërgohet në gjykatën e apelit ose në organin përkatës administrativ.

45.5 Nëse pronarët e një banke dëshirojnë që vullnetarisht të likuidojnë bankën sipas Ligjit për Shoqëritë, Ligjit për ndërmarrjet, ose sipas ndonjë ligji mbi paaftësinë paguese a falimentimin, ose sipas ndonjë statuti tjetër përkatës, ata duhet të paraqesin kërkesë në BPK për miratimin e likuidimit vullnetar të shoqëruara me informacion tjetër ashtu si përcaktohet nga BPK-ja. BPK-ja bën shqyrtimin e duhur të veprimtarisë së bankës dhe mund të miratojë likuidimin vullnetar sipas legjislacionit në fuqi ose të vendosë të zbatohet kjo rregullore dhe të emërojë një kujdestar në përputhje me nenin 39.

DISPOZITAT E NDRYSHME

Neni 46

AUTORITETI RREGULLATOR DHE MBIKËQYRËS I BPK-së

BPK-ja autorizohet të nxjerrë rregullore, urdhresa dhe udhëzues për të vizituar zyrat e bankave dhe të institucioneve financiare në kohën që ajo mendon se është e arsyeshme, për të kontrolluar llogaritë, librat, dokumentet dhe regjistrimet e tjera dhe të marrë masat që ajo mendon se janë të nevojshme a të këshillueshme për përmbushjen e synimeve të kësaj rregulloreje ose rregullave ose urdhresave të nxjerra sipas kësaj rregulloreje.

Neni 47

RREGULLORET DHE URDHRESAT E BPK-së; TARIFAT

47.1 BPK-ja boton rregullat dhe urdhëresat e saj të cilat hyjnë në fuqi në datën e botimit ose në një datë të mëvonshme të specifikuar në rregullore ose në urdhresë.

47.2 BPK-ja cakton tarifa për bankat dhe institucionet financiare për shërbimet rregullatore dhe të mbikëqyrjes, për të paguar shpenzimet direkte apo indirekte të bëra për kryerjen e këtyre shërbimeve. Tarifat ndaj bankave llogariten në bazë të shumës së aktivës të tyre ose në bazë të shpenzimeve të jashtëzakonshme të bëra nga BPK-ja apo nga agjentët e saj në lidhje me aktivitetet mbikëqyrëse rreth një banke të caktuar. Bankat duhet të paguajnë këto tarifa brenda 10 ditëve nga dita e paraqitjes së deklaratës nga BPK-ja.

Neni 48

SHQYRTIMET GJYQËSORE

Në një procedurë gjyqësore, gjykatë të arbitrazhit ose organ administrativ të çdo juridiksioni të ngritur kundër BPK-së për çfarëdo veprimi të ndërmarrë në cilësinë e saj të mbikëqyrësit ose drejtorit a kundër cilitdo zyrtari, nëpunësi apo agjenti të saj shtrohet:

- (a) E vetmja pyetje para gjykatës a organit është të vendosë nëse i padituri ka vepruar në mënyrë të paligjshme, të gabuar ose në pakujdesi, nëse haptas i ka tejkalluar kompetencat ose ka vepruar në mënyrë arbitrare a kapricioze, duke njohur gjithë faktet dhe rrethanat, dispozitat dhe synimet e kësaj rregulloreje, rregullave, urdhresave dhe legjislacionit në fuqi;
- (b) Asnjë ish-zyrtar, punonjës ose agjent ose që akoma punojnë në BPK nuk është përgjegjës për

dëmet, veprimet ose mosveprimet e kryera në mirëbesim gjatë kryerjes së detyrave të tij/saj dhe

- (c) Veprimi i ndërmarrë që është subjekt i këtyre procedurave do të vazhdojë pa kufizime gjatë procedurave dhe periudhës së një ankimi ose shqyrtimi gjyqësor derisa të ndërpritet nga një gjykatë e juridiksionit kompetent.

Neni 49

INTERPRETIMI

49.1 Titujt e neneve në këtë rregullore janë përdorur vetëm për lehtësi referimi dhe nuk janë pjesë apo nuk kanë synim të drejtojnë, kufizojnë ose ndihmojnë në kuptimin e ndonjë termi a dispozite të kësaj rregulloreje.

49.2 Termat e përdorur në lidhje me njëri tjetrin ose jo në lidhje me njëri tjetrin në këtë rregullore mund të lexohen edhe anasjelltas sa herë që ndryshimi është i nevojshëm për të qartësuar kuptimin e dispozitës në fjalë.

49.3 Fjalët e përdorura në njëjës në këtë rregullore mund të lexohen edhe në shumës dhe anasjelltas sa herë që ndryshimi është i nevojshëm për të qartësuar kuptimin e dispozitës në fjalë.

Neni 50

ZBATIMI

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ka kompetencë të nxjerrë direktiva administrative për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 51

LEGJISLACIONI NE FUQI

Dispozitat e legjislacionit në fuqi zbatohen në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 52

HYRJA NE FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi më 15 nëntor 1999.

Neni 53

DISPOZITAT KALIMTARE

53.1 Personat juridikë që në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje kryejnë veprimtari të një banke në Kosovë, dhe që dëshirojnë të veprojnë si një bankë në Kosovë duhet të paraqesin kërkesë në përputhje me nenin 7 brenda 30 ditëve nga ajo datë. Personat juridikë që nuk kanë paraqitur kërkesë në atë datë ose kërkesa e të cilëve është refuzuar në përputhje me dispozitat e nenit 7, pushojnë kryerjen e veprimtarisë bankare brenda 30 ditëve apo e mbyllin aktivitetin e tyre. BPK-ja mund të emërojë një kujdestar për të likuiduar aktivitetin e personave juridikë të detyruar të mbyllin aktivitetin e tyre në përputhje me dispozitat e këtij neni.

53.2 Brenda periudhës së përcaktuar nga BPK-ja (i cili nuk do të jetë më vonë se 31 dhjetori 2000), me urdhresë për një bankë organizimi, administrimi, kushtet financiare ose veprimtaria e të cilës nuk përputhet me një ose më tepër nga kërkesat materiale të kësaj rregulloreje ose me ndonjë rregull a urdhresë, kjo bankë menjëherë duhet të ndërmarrë masa në përputhje me kërkesat e specifikuar brenda një periudhe sa më të shkurtër që është e mundur.

53.3 Bankat e licencuara, të cilat janë regjistruar në regjistrin qendror, siç kërkohet me nenin 9 dhe operojnë si banka, për arsye të shumta do të konsiderohen si shoqëri akcionare me përgjegjësi të kufizuar apo si shoqëri kooperative sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë deri sa të hyjë në fuqi ndonjë ligj për ndërmarrje, shoqëri ose kooperative, sipas rastit, në përputhje me legjislacionin e përmendur në fuqi dhe pas miratimit të BPK-së, organizimi i tyre zyrtar hyn në fuqi menjëherë.

53.4 Nëse ligji mbi ndërmarrjet ose shoqëritë nuk hyn në fuqi brenda pesë (5) vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, BPK-ja do të ketë kompetencë të shqyrtojë statusin e të gjitha licencave të dhëna dhe do të ndërmarrë veprimet përkatëse për zgjidhjen e problemit ashtu si e gjykon ajo të arësyeshme.

Bernard Kouchner
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm